



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 141-Gusht 2015 - ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



FESTIVALI "ODA E LLAPUSHËS" –EDICIONI I DYTË

MALISHEVË, 1-2 GUSHT 2015

Përmbajtja:

U hap panairi artizanal në Malishevë	3
U mbajt nata e parë e festivalit “Oda e Llapushës”	4
“Shotë Galica” dhe “Ramaja” fituese të festivalit “Oda e Llapushës”	5
Mërgimtarët të interesuar të ndihmojnë sportin në Malishevë.....	6
Në Zvicër do të formohet shoqata “Malisheva”	7
Filloi dhënia e certifikatave të veteranëve të Brigadës 121, ZO e Pashtrikut.....	8
Ministria e Arsimit, ende nuk e ka siguruar inventarin për shkollat e reja.....	8
Begaj, takoi ushtarakët zviceran të LMT-së në Malishevë.....	9
Filloi asfaltimi i rrugës Dragobil – Pallanka	10
Shumë projekte infrastrukturore në realizim e sipër në Malishevë.....	11
Malisheva po e shënon Ditën e Rinisë	12
Filloi asfaltimi i rrugicave në lagjen e Gurit në Malishevë	13
Nis ndërtimi i murit mbrojtës për shkollën e Shkozës	14
Komuna dhe OSBE vlerësojnë lartë bashkëpunimin e ndërsjellë	15
Këshilli i Drejtorëve mbajti takimin e rregullt	16
U mbajt dëgjimi i parë publik për projekt buxhetin 2016-2018	17
Hyseni: Radikalizmi fetar, në kundërshtim me ajetet kuranore	18
Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) mbajti mbledhjen e tetë të rregullt.....	19
Nga 1 shtatori ndalohet ekspozimi i mallit para lokaleve dhe sipërfaqeve tjera publike.....	19
Krasniqi: 3.8 milion euro për investime në vitin 2016	20
Në ditën e Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”, nderohen dëshmorët e kombit.....	21
Pastrohet shtrati i lumit Mirusha, pjesa që kalon nëpër qytet.....	21
Komiteti për Komunitete, mbajti mbledhjen e rregullt	22

U hap panairi artizanal në Malishevë

Malishevë, 1 gusht



Krahas mbajtjes së Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”, në Malishevë, sot është hapur edhe panairi artizanal, ku po prezantohen punimet e dorës si dhe të ushqimeve tradicionale, me qëllim të ruajtjes së traditës dhe njoftimit të gjeneratave të reja me traditën shqiptare.

Krahas veshjeve popullore dhe punimeve tjera zbukuruese, në këtë panair janë të prezantuara edhe materiale tjera nga druri si

veku pastaj “qilima”, veshje tjera tradicionale, pastaj ushqime tradicionale dhe të tjera.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, bëri hapjen e panairit i cili me këtë rast tha: “Unë shfrytëzoj rastin që në emër të komunës, të kryetarit, dhe DKRS-së, të ju falënderoj për prezencën tuaj këtu, me ekspozimet tuaja, dhe natyrisht do të bëjmë përpjekje me e ngjallë këtë zejt, artizanal që mungojnë pak a shumë, tash në këto kohëra dhe konsideroj që gjeneratë pas gjenerate duhet mbështetur këtë lloj pune, për arsyeje se ne gjeneratat e mëhershme edhe jemi rritur me këto veshje, dhe meriton të merremi me këtë, dhe të vazhdojmë e të ngjallim këto vlera” tha Mazreku, duke i inkurajuar të punojnë në këtë drejtim dhe që institucioni do të i mbështes edhe në vazhdimësi e vetëm e vetëm që mos të humbin këto vlera.



Në këtë panair, veç prezantuesve të punimeve nga vendet e ndryshme të Kosovës, vlen të veçohen edhe mysafirët nga Shqipëria të cilët kontribuanë në këtë panairi me punime të ndryshme. Përndryshe këtë panairi, po e vizitojnë shumë qytetar, ndërsa më kureshtar duket të jenë mërgimtarët, të cilët edhe janë blerësit kryesor në këtë panair.

U mbajt nata e parë e festivalit “Oda e Llapushës”

Malishevë, 1 gusht



Sonte, në Malishevë, ka filluar festivali folklorit “Oda e Llapushës”, edicioni i dytë, ndërsa në këtë festival të folklorit, po marrin pjesë shoqëri, grupe dhe këngëtar nga të gjitha trojet shqiptare, Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Lugina e Preshevës, Mali i Zi, diaspora, e deri nga Amerika e largët. Ky festival, përveç garës në fushën e folklorit,

mbahet në kuadër të “Ditëve të Mërgatës” dhe organizohet nga Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në hapjen zyrtare të festivalit, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit, mërgimtarët, kryetarin e “Nisma për Kosovën, z.Fatmir Limaj, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Haxhi Shala, Enver Hoti, Shukrie Bytyçi, Salih Morina, mysafirët nga të gjitha trojet shqiptare, tha se kjo është hera e dytë që mbahet ky festival dhe do të jetë tradicional. “Janë shumë arsye që ky festival i takon të mbahet në Malishevë, pasi kjo trevë, është më e njohura në fushën e folklorit. Unë sonte po përmendi edhe dy ngjarje që lidhen me këtë vit, pasi është 49 vjetori kur rapsodët tanë Sali e Feriz Krasniqi, zunë vendin e parë në festivalin e rapsodëve në Londër, si dhe këtë vit, bëhen 40 vite nga vdekja e Sefë Mleqanit, njeriut që i dha aq shumë këngës dhe folklorit shqiptar”, tha Begaj. “Unë sonte, dua ti falënderoj të gjithë bashkatdhetarët tanë që me kontributin e tyre mbajtën gjallë arsimin shqip në kohët më të vështira, pastaj ndihmuat luftën çlirimtare dhe ndihmuat edhe pas luftës”, tha Begaj, duke i përshëndetur të gjithë mërgimtarët. “Sonte është natë gëzimi, ndërsa të gjithë juve që merrni pjesë në festival, ju dëshiroj shumë suksese”, tha në fund kryetari Begaj.

Para fillimit të garës, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka ndarë gjashtë mirënjohje, për kontributin e tyre për Malishevën. Mirënjohje ju nda bashkatdhetarëve Bashkim Thaçi, Agim Krasniqit, Halim Hotit, pastaj sportistit dhe kampionit të botës në kik boks Dardan Morinës, si dhe mirënjohje ju ndanë edhe Behram Hotit dhe Xhevat Kryeziut për kontributin e tyre në pajtimin gjaqevë.

Festivali u hap me paraqitjen e SHKA “Sali e Feriz Krasniqi” nga Malisheva, për të vazhduar me paraqitjen e tyre edhe shoqëritë, grupet dhe këngëtarët tjerë, të folklorit, ku u paraqitën me këngë e valle nga tradita jonë, nga të gjitha trevat shqiptare.

Paraprakisht, pjesëmarrësit, kanë defiluar rrugëve të qytetit të Malishevës.

Festivali, do të mbyllet nesër, ku juria profesionale, e përbërë nga njohësit e fushës së folklorit dhe traditës shqiptare, e përbërë nga Istref Dobi, Zymer Neziri dhe Adem Zejnullahu, do të vendosin për paraqitjet më të mira në këtë festival, të cilët do të shpërblehen nga organizatori.

“Shotë Galica” dhe “Ramaja” fituese të festivalit “Oda e Llapushës”

Malishevë, 2 gusht



Sonte në Malishevë, ka përfunduar festivali tradicional i folklorit “Oda e Llapushës”, ndërsa vendin e parë të festivalit e ndanë ansamblet “Shotë Galica” nga Drenasi dhe “Ramaja”, çmim të cilin, ju dha i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj. Në këtë festival, të dytin me radhë, morën pjesë ansamble, shoqëri, grupe dhe këngëtar të folklorit nga të gjitha trojet shqiptare.

Festivali “Oda e Llapushës”, mbahet në kuadër të ditëve të mërgatës në Kosovë dhe me këtë rast, Komuna e Malishevës, ka ndarë mirënjohje për mërgimtarët, të cilët kanë dhënë

kontribut të veçantë për Malishevën dhe për Kosovën, ndërsa sonte, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka ndarë mirënjohje edhe për familjet nga Malisheva, që kanë kontribuar në kulturën shqiptare. Mirënjohje janë ndarë për familjen e Sali e Feriz Krasniqit, për Sefë Mleqanin dhe për Nexhmije Pagarushën, emra këta që kanë lënë gjurmë dhe kanë histori në kulturën shqiptare.

Vendin e dytë në festivalin e folklorit “Oda e Llapushës”, e kanë ndarë “Visaret e Krrabës” dhe Naim Krasniqi, ndërsa vendin e tretë e kanë ndarë Vëllezërit Kryeziu dhe Vëllezërit Bytyçi. Po ashtu, në kuadër të festivalit janë ndarë çmime për grupin më të kompletuar, pastaj çmimi i karrierës, i publikut, çmimi “Beqir Gashi” për debutantin e festivalit si dhe çmimi i veteranit të folklorit.

Në fund të festivalit, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerita Krasniqi, njëherit edhe drejtoreshë e festivalit, i ka falënderuar të gjithë për pjesëmarrje, pastaj të gjithë ata që kanë ndihmuar në realizimin e festivalit, vullnetarët e Qendrës Rinore në Malishevë, dhe të tjerët që kanë dhënë kontribut në organizimin dhe mbajtjen e festivalit.

Edicioni i tretë i festivalit, do të mbahet vitin e ardhshëm.

Mërgimtarët të interesuar të ndihmojnë sportin në Malishevë

Malishevë, 4 gusht

Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerita Krasniqi, kanë pritur në një vizitë mërgimtarin nga Shkoza i cili jeton dhe vepron në Gjermani, z.Afrim Bytyçi, i cili ka shprehur interesim të ndihmoj sportin në Malishevë më konkretisht futbollin. Në këtë vizitë, së bashku me z.Bytyçi, ishte edhe trajneri i mirënjohur kosovar në futboll, z.Ismet Munishi .



Me këtë rast, kryetari Begaj, tha se “mërgimtarët, në vazhdimësi në të gjitha fushat i kanë përkrahur dhe mbështetur të gjitha zhvillimet, përfshi edhe sportin, andaj unë ju falënderoi për interesimin tuaj, për përkrahjen e sportit, përkatësisht futbollit, për të cilin ne si Malishevë kemi nevojë për mbështetjen e të gjithë”.

Nga ana tjetër mërgimtari z.Afrim Bytyçi, pasi shprehi interesim për të ndihmuar sportin në Malishevë, më konkretisht futbollin, e kanë vizituar stadiumin e qytetit në Malishevë. Z.Bytyçi, bëri të ditur, se së bashku me mërgimtarin nga Bellanica, z.Blerim Hoxha janë të interesuar që të ndihmojnë në zhvillimin e futbollit në Malishevë.

Kryetari Begaj, u takua me bashkatdhetarët

Në Zvicër do të formohet shoqata “Malisheva”

Malishevë, 7 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot është takuar me bashkatdhetarët tanë, që jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme dhe që aktualisht gjinden në vendlindje, me të cilët ka bashkëbiseduar për çështje të ndryshme. Në këtë takim, u bë e ditur se bashkatdhetarët në Zvicër, deri në fund të gushtit, do ta formojnë shoqatën “Malisheva”.

“Qëllim i këtij takimi është, që të takohemi dhe të bashkëbisedojmë për çështje të ndryshme me interes për ju bashkatdhetar. Të jetosh larg vendit tënd, është e vështirë, por rrethanat e kohës, ju kanë imponuar këtë, mirëpo kontributi juaj për vendin, është shumë i madh, pasi ju jeni ata që përveç familjeve tuaja, e keni mbajtur edhe jetën institucionale, edhe luftën edhe zhvillimin e pasluftës, përmes kontributit që vazhdueshëm që jepni për vendin. Ne si komunë, po mundohemi që të angazhohemi maksimalisht në ofrimin e shërbimeve për çdo gjë që keni nevojë. Ju e mira e këtij vendi dhe e keni për borxh që t’ju ofrojmë shërbimet dhe respektin që meritoni”, tha mes tjerash në fjalën e tij, i pari i Malishevës, Ragip Begaj.

Më pas u diskutua për çështje të ndryshme, me të cilat përballen bashkatdhetarët, gjatë qëndrimit në vendlindje. Nga folësit në këtë takim, nuk pati ankesa në ofrimin e shërbimeve nga ana e komunës, përderisa ngritën shqetësimet e tyre, lidhur me gjendjen e ambientit, për shkak të hedhjes së mbeturinave, vend e pa vend, pastaj në disa raste, për vendosjen e pengesave në rrugët, nga ana e qytetarëve, pranë shtëpive, mungesa e tabelave informuese nëpër vendbanime dhe mungesa e tabelave me emërtimet për rrugët, në fshatrat ku jetojnë.

Ndërsa bashkatdhetari, z.Istref Rudaj, bëri të ditur, se me iniciativë të mërgimtarëve në Zvicër, kanë nisur procedurat dhe deri në fund të gushtit, do ta formojnë shoqatën “Malisheva” në Zvicër, e cila do të ketë kryesisht karakter humanitar dhe kulturor, dhe në të njëjtën kohë ju bëri thirrje bashkatdhetarëve nga Malisheva, që ti bashkohen kësaj shoqate dhe të japin kontributin e tyre.

Filloi dhënia e certifikatave të veteranëve të Brigadës 121, ZO e Pashtrikut

Malishevë, 8 gusht

Sot, zyrtarisht ka filluar shpërndarja e certifikatave të veteranëve luftëtar të UÇK-së, për luftëtarët e Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”, Zona Operative e Pashtrikut. Në fillimin e shpërndarjes së certifikatave, ishin të pranishëm, përfaqësuesit e ZO të Pashtrikut, Kryetari i Malishevës dhe zyrtar nga Shoqata e Veteranëve të Luftës së UKÇ-së në Malishevë. Dhënia e certifikatave, bëhet çdo ditë në zyrat e shoqatës, në objektin e Komunës së Malishevës.



Nga fundi i javës së ardhshme, pritet shpërndarja e certifikatave edhe pjesëtarët e Brigadës 122 “Imer Krasniqi”.

Ministria e Arsimit, ende nuk e ka siguruar inventarin për shkollat e reja

Malishevë, 10 gusht

Edhe pse jemi në prag të fillimit të vitit të ri shkollor dhe drejtoria komunale për arsim dhe edukim, është duke i bërë të gjitha përgatitjet për një fillim sa më të mirë të vitit shkollor 2015-2016, duke përfshi edhe ndërtimin e objekteve të reja shkollore, Ministria e Arsimit, ende nuk ka siguruar inventarin për objektet e reja shkollore në Malishevë.

Këtë problem, sot e ka paraqitur, drejtori komunal për arsim dhe edukim, z.Blerim Thaçi, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve. Sipas drejtorit Thaçi, Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, është përgjegjëse për sigurimin e inventarit në objektet e reja shkollore, por deri më tani, se paku për dy shkollat, të cilat janë gatshme (në Damanek dhe në Carrallukë), por edhe për objektet tjera të cilat janë në përfundim e sipër dhe pritet të jenë të gatshme për shtator. Po ashtu, drejtori Thaçi, ka adresuar kritika edhe për Agjencionin për Arsim Profesional, i cili në mënyrë të njëanshme e ka shpallur konkursin për pranimin e kuadrit mësimdhënës në Qendrën e Kompetencës në Malishevë, ndërsa Komuna e Malishevës, është tërhequr nga marrëveshja për menaxhimin e kësaj qendre nga ana e agjencionit. Për autonomi të shkollave profesionale dhe kundër centralizimit të tyre, ishin deklaruar edhe ministri i MASHT-it, z.Arsim Bajrami dhe kryetari Begaj, gjatë vizitës që i kishte bërë ministri Bajrami, kësaj qendre me 5 maj të këtij viti, mirëpo, Agjencionin, ka

vazhduar me veprimet e saja të njëanshme. Përndryshe, kryetari i Komunës së Malishevës, e ka tërheq nënshkrimin e tij, me këtë agjencion, për memorandumimin e mëhershëm për menaxhimin e Qendrës së Kompetencës në Malishevë, dhe për këtë veprim, i ka njoftuar të gjitha organet kompetente.

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, i cili udhëhiqet nga kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, u bë e ditur, se janë duke vazhduar punimet në disa projekte, si në rrugë, kanalizime, pastaj në infrastrukturë shkollore dhe të tjera. Po ashtu, u njoftua edhe me raportin e auditorit të përgjithshëm, lidhur me raportin e krahasimit të shpenzimeve dhe të të hyrave, ku Komuna e Malishevës, është e renditur shumë mirë në këtë raport, dhe në ditët në vijim, pritet të bëhet një analizë e këtij raporti dhe komuna do të del me komentet e saj lidhur me raportin.

Po ashtu nga drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, u bë e ditur, se sot ka filluar edhe faza e katërt e repelimit të kafshëve, projekt i cili realizohet në kuadër të strategjisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), strategji e cila, deri më tani ka treguar rezultat të mirë, pasi numri i thumbimeve nga rriqrat, ka rënë në masë të dukshme. Se numri i thumbimeve nga rriqrat, ka shënuar rënie të dukshme, e ka konfirmuar edhe drejtori komunal për shëndetësi z.Hajdin Berisha, i cili situatën me EHKK, e vlerësoi të mirë, pasi nuk kemi asnjë rast të shënuar me EHKK. Edhe kryetari Begaj, e ka përsëritur angazhimin e të gjitha strukturave komunale dhe institucioneve tjera, përfshi edhe shëndetësinë, për parandalimin e EHKK-së dhe ka shprehur kënaqësinë e tij, pasi këtë vit, nuk ka raste të infektimit nga ky virus vdekjeprurës dhe ky është viti i dytë që nuk kemi raste të tilla të vdekjeve.

Ndërsa drejtorja për kulturë, rini dhe sport, ka bërë të ditur, se janë në përfundim të përgatitjeve për organizimin e Ditës së Rinisë, më 12 gusht të këtij viti, ku edhe organizatat rinore, kanë përgatitur disa aktivitete për këtë datë të shënuar për rininë.

Sa i përket situatës me zjarre dhe aksidente, sipas drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, ka ende shumë raste të zjarreve kryesisht fushore dhe aksidente në rrugë, për çka njësia e zjarrfikësve dhe shpëtimit, ju duhet disa here brenda ditës, të intervenojnë. Me këtë rast ju bëhet thirrje qytetarëve, që në çdo rast të lajmërohen në numrin pa pagesë 112.

Begaj, takoi ushtarakët zviceran të LMT-së në Malishevë

Malishevë, 11 gusht

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim të rregullt, përfaqësuesit e Liaison Monitoring Team (LMT) të KFOR-it zviceran, të cilët veprojnë në Malishevë, kapitenin Flavio Lötscher, me të cilin biseduan për zhvillimet e përgjithshme në Komunën e Malishevës.



Kryetari Begaj, e vlerësoi lartë misionin e KFOR-it në Kosovë dhe angazhim e të gjithë ushtarakëve të KFOR-it, përfshi edhe njësitë e LMT-së, njësi me të cilën, Komuna e Malishevës, bashkëpunon ngushtë dhe kanë raporte të mira të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Begaj dhe Lötsher, biseduan për rrjedhat e përgjithshme në Komunën e Malishevës, zhvillimet, projektet që janë duke u realizuar dhe nevojat që kanë vendbanimet në Malishevë, si dhe për çështje tjera, me interes të ndërsjellë.

Filloi asfaltimi i rrugës Dragobil – Pallanka

Malishevë, 11 gusht

Në kuadër të realizimit të investimeve kapitale të Komunës së Malishevës dhe në kuadër të përpjekjeve të komunës, për ndërtimin dhe rregullimin e infrastrukturës rrugore, me qëllimin të sigurimit të qarkullimit më të lehtë të qytetarëve dhe lidhjes së rrugëve të fshatrave, me lagjet e tyre, sot është duke u asfaltuar rruga e cila lidh lagjen Pallanka me fshatin Dragobil.



Rruga e gjatë afër dy kilometra, e cila lidh këtë lagje me fshatin Dragobil dhe me magjistralen Prishtinë – Rahovec, në të njëjtën kohë, është e urë lidhëse e rrugës Malishevë – Rahovec me rrugën Malishevë-Kijevë, duke e mundur kështu, jo vetëm lidhjen e lagjes me fshatin, por edhe shkarkimin e rrugëve në qendrën komunale.

Asfaltimin e kësaj rruge, e kanë parë nga afër edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i Urbanizmit, z.Skënder Rrahmanaj, të cilët u ndanë të kënaqur me punimet e bëra në këtë rrugë, e cila është shumë e rëndësishme për banorët e fshatit Dragobil dhe më gjerë.

Kryetari Begaj, me këtë rast i ka uruar banorët e këtij fshati, për rrugën, e cila prej tani e mundëson lidhjen e kësaj lagje me fshatin dhe më nuk kanë nevojë, që për të shkuar nga

fshati në lagje dhe anasjelltas, të shkojnë së pari në Malishevë, e pastaj të lidhen në lagje apo në fshat.

Ndërtimi i kësaj rruge, së bashku me dy rrugë tjera më të shkurtra, buxhetit komunal të Malishevës, i kanë kushtuar afro 188 mijë euro.

Shumë projekte infrastrukturore në realizim e sipër në Malishevë

Malishevë, 12 gusht

Komuna e Malishevës, aktualisht, është duke realizuar disa projekte që lidhen me infrastrukturën në përgjithësi, si rrugë, trotuare dhe në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor, është duke u punuar në rregullimin e infrastrukturës shkollorë, përkatësisht në

ndërtimin e fushave të jahte të sportit dhe oborreve të shkollave.



Sipas drejtorit komunal të urbanizimit, Skënder Rrahmanaj, “aktualisht është punuar në rregullimin e oborrit të shkollës në Burim, riparimi i rrethojës së fushës së sportit në Dragobil dhe drenazhimi i fushës së sportit në Pagarushë, të cilat kapin një vlerë prej nëntë mijë e katërqind euro, ndërsa fusha të reja të sportit, janë duke u

ndërtuar në Gurbardh dhe Tërpezë të Ulët, fusha për ndërtimin e të cilave janë ndarë 43 mijë e 980 euro”.

“Po ashtu jemi duke e ndërtuar trotuarin në fshatin Astrazup, trotuar i cili shtrihet përgjatë magjistrales Prishtinë-Rahovec, e që ka rëndësi të madhe për lëvizjen e qytetarëve, e sidomos të fëmijëve, të cilët udhëtojnë përgjatë rrugës për në shkollë. Ky trotuar, i kushton buxhetit komunal 23 853 euro”, tha drejtori Rrahmanaj.



Ecurinë e punimeve në këto projekte e kanë parë nga afër Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit Skënder Rrahmanaj, ndërsa u deklaruan se “Komuna e Malishevës, do të vazhdojë me investime, sipas nevojave të paraqitura nga ana e qytetarëve dhe që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve më të mira, në këtë rast për qytetarët dhe në veçanti të nxënësve, pasi gradualisht, po kompletohet infrastruktura shkollorë dhe po krijohen kushte më cilësi më të madhe në arsim,

si dhe po investohet në rrugë e trotuare, me qëllim të lëvizjes më të sigurt për qytetarët”. Sipas drejtorit Rrahmanaj, punimet po ecin sipas planifikimeve të bëra dhe brenda afateve.

Malisheva po e shënon Ditën e Rinisë

Malishevë, 12 gusht



Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Malishevës, në bashkëpunim me OSBE misioni në Kosovë, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) dhe Qendra për rini, sot po shënojnë 12 gushtin, Ditën Ndërkombëtare të Rinisë. Gjatë këtyre organizimeve, janë shënuar një varg aktivitete rinore, si prezantime, debate, debate me të rinjtë mërgimtarë, trajnime dhe aktivitete tjera në hapësirat e parkut

të qytetit.

Sipas zyrtarit komunal për rini, Mehdi Krasniqi, në këto aktivitete, “përveç KVRL të Malishevës dhe Qendrës së rinisë në Malishevë, po marrin pjesë edhe organizatat e KVRL-ve dhe Qendrave Rinore të komunave përreth Malishevës, ndërsa aktivitetet janë të larmishme dhe po prezantohen vlerat e të rinjve malishevas”.

Aktivitetet, sipas zyrtarit Krasniqi, kanë filluar me një prezantim të OJQ-ve rinore, pastaj prezantim i rregullores për vullnetarizëm, dhe më pas të rinjtë ka dalë në park të qytetit për ti zhvilluar aktivitetet e tyre, si dhe kanë shpërndarë fletushka për promovim të vullnetarizmit në Komunën e Malishevës, me moton “Bashkohu edhe ti”.

Krasniqi, bëri të ditur, se aktivitetet që momentalisht po vazhdojnë, janë debati me rininë e diasporës, pastaj trajnime rreth ndihmës së parë, të cilin e mban Kryqi i Kuq i Kosovës, dega në Malishevë dhe aktivitetet kulturore, do të vazhdojnë deri në mbrëmje në parkun e qytetit në Malishevë.

Filloi asfaltimi i rrugicave në lagjen e Gurit në Malishevë

Malishevë, 13 gusht



Sot në qytetin e Malishevës, përkatësisht në lagjen e “Gurit”, ka filluar asfaltimi i rrugicave në këtë lagje, me qëllim të lëvizjes më të lehtë të banorëve të kësaj lagjeje dhe për qëllim të rregullimit të infrastrukturës urbane brenda qytetit. Me rregullimin e këtyre rrugëve, Malisheva, gradualisht po kompletton infrastrukturën e saj edhe brenda lagjeve.

Lagja e “Gurit”, llogaritet si njëra prej lagjeve më të vjetra të Malishevës, ndërsa pjesa më e madhe e lagjes, e ka infrastrukturën e rregulluar dhe me asfaltimin e këtyre rrugicave, lagjja po e merr pamjen e një lagje urbane, ku banorët e saj nuk kanë problem as me rrugë, as me kanalizim, sikur edhe me ujë për pije.

Punimet në rrugicat e lagjes së “Gurit”, i kanë inspektuar sot edhe kryetari Begaj me drejtorin e urbanizimit Skënder Rrahmanaj, të cilët edhe i kanë uruar banorët për rregullimin e infrastrukturës dhe asfaltimin e rrugicave. “Pavarësisht buxhetit shumë të kufizuar që ka Malisheva, ne mundohemi që investimet ti drejtojmë në shërbim të qytetarit. Tash kjo pjesë e lagjes, me asfaltimin e rrugës, po e kompletton infrastrukturën e saj dhe ky është edhe qëllimi ynë, që banorëve t’ju krijojmë kushte sa më të mira për jetesën e tyre në të gjitha vendbanimet, edhe pse nevojat e qytetarëve shtohen çdo ditë, sipas zhvillimeve të kohës, por ne do të mundohemi të jemi gjithmonë pranë qytetarit”, tha kryetari Begaj dhe uroi që banorët e kësaj pjese, ti gëzojnë këto investime të komunës

Rrugicat e pjesës jug-lindore të lagjes së “Gurit”, të cilat po asfaltohen sot, kanë një gjatësi prej afro shtatëqind metrave dhe pjesë e projekteve të Komunës së Malishevës, në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore nëpër vendbanimet në tërë territorin e Komunës së Malishevës.

Nis ndërtimi i murit mbrojtës për shkollën e Shkozës

Malishevë, 13 gusht

Kanë filluar punimet për ndërtimin e murit mbrojtës në pjesën e pasme të objektit të shkollës në fshatin Shkozë, të Komunës së Malishevës. Vitin e kaluar kanë përfunduar punimet në ndërtimin e objektit të shkollës, mirëpo, pjesa e pasme e objektit rrezikohet nga shembjet e mundshme të gurëve dhe dheut, dhe për këtë qëllim, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, nuk kishte lejuar fillimin e mësimin, pa u siguruar pjesa e pasme e objektit me muri mbrojtës.

Vendimi i kryetari Begaj, ishte vendim i drejtë, pasi gjatë dimrit dhe reshjeve të mëdha, kishte ndodhur rrëshqitje e gurëve dhe dheut, duke dëmtuar një pjesë të murit të shkollës, dëme të cilat të dukshme edhe sot.

Për ta hapur shkollën në fillim të këtij shkollor, Komuna e Malishevës, ka hartuar një projekt dhe filluar realizimin e projektit, për ngritjen e një muri mbrojtës, me qëllim të shmangies të rrëshqitjeve të gurëve dhe dheut.

Punimet në ndërtimin e këtij muri, i ka inspektuar sot, vet kryetari Begaj, ku është ndarë i kënaqur me punimet që po kryhen. “Jam i kënaqur pasi ka filluar ndërtimi i këtij muri dhe nxënësit e Shkozës dhe Janiqistit, lirshëm mund të fillojnë mësimin në objektin e ri, pa ndier rrezikuar, ndërsa edhe ne mund ta hapin tani objektin e shkollës, pasi tani po krijohet siguri për nxënësit”, tha Begaj, sot në Shkozë.



Komuna dhe OSBE vlerësojnë lartë bashkëpunimin e ndërsjellë

Malishevë, 14 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim njoftues, zyrtarët e lartë të misionit të OSBE-së, për regjionin Prizrenit dhe ekipin komunal të OSBE-së, përkatësisht drejtorin regional të OSBE-së, z.Norman Spitzegger, pastaj përgjegjësin për ekipet komunale, z.George Katcharava dhe zyrtarët tjerë . Në këtë takim, u vlerësua lartë bashkëpunimi i ndërsjellë, si dhe

nga ana e OSBE u vlerësua angazhimi i komunës, në përfshirjen në vendimmarrje të liderëve të fshatrave dhe të rinisë.

Fillimisht, kryetari Begaj, i falënderoi OSBE-në për bashkëpunimin e mirë dhe të vazhdueshëm, që kanë me Komunën e Malishevës, si dhe për raportimet korrekte nga monitorimi i punës së legjislativit dhe ekzekutivit, ndërsa më pas është përgjigjur edhe në interesimet e zyrtarëve të OSBE-së, lidhur me çështje të ndryshme me interes të ndërsjellë.

Drejtori regional i OSBE-së në Prizren, z.Normal Spitzegger, pasi e njoftoi kryetarin Begaj me ekipin e ri të OSBE-së, me z.Yusuke Hara, z.Salih Elshanin, si dhe me zyrtarin për komunitete në OSBE, z.Orce Bonev, e vlerësoi lartë angazhimin e kryetarit, në vizitat e vazhdueshme në terren, vizita përmes së cilave, përmbush edhe obligimet ligjore, si dhe përfshirjen e liderëve të fshatrave dhe të rinjve në vendimmarrje.

Kryetari Begaj dhe zyrtarët e OSBE-së, më pas kanë biseduar për çështje të ndryshme, që kanë të bëjnë me zhvillimet e përgjithshme në Komunën e Malishevës, pastaj angazhimet e komunës në hartimin e strategjisë për vizita në terren dhe komunikim, rregullores për transparencë, si dhe rregulloreve tjera.

Po ashtu u bisedua edhe për çështjen e komuniteteve në Komunën e Malishevës, ku OSBE, po ashtu e vlerësoi angazhimin e komunës, për përfshirjen e komunitetit RAE, në organet komunale, si dhe në organizmat tjerë, përmes së cilës, ky komunitet, edhe pse i pakët në numër, është i inkuadruar mirë në shoqërinë e Malishevës.

Drejtori Spitzegger, duke folur për vizitat në terren dhe takimet e drejtpërdrejta me qytetar, tha se “ky është një shembull i mirë, edhe për komunat tjera”, përderisa tha se ky komunikim me qytetarët është edhe obligim ligjor. Ndërsa kryetari Begaj, tha se “ bashkëpunimi me qytetarin, është obligativ dhe unë i përgjigjem qytetarit, sepse qytetarët ma kanë dhënë besimin ta drejtoj komunën në këtë mandat dhe të gjithë qytetarët, pa dallime partiake, janë të

barabartë, ndërsa unë obligohem të jem me qytetarët në vazhdimësi dhe nevojat e tyre, kërkesat e tyre, gjithmonë do ti kemi parasysh gjatë hartimit të buxhetit komunal, përkatësisht hartimit të projekteve kapitale”.

Këshilli i Drejtorëve mbajti takimin e rregullt

Malishevë, 17 gusht

Këshilli i Drejtorëve, i drejtuar nga i pari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të së hënës, ku drejtorët e drejtorive kanë paraqitur aktivitetet e tyre gjatë javës që lamë pas dhe planifikimin për javën në vijim, ku do të ketë disa aktivitete me rëndësi, siç është debati publik për projekt buxhetin e vitit 2016.

Sipas drejtorit të drejtorisë për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, drejtorja që ai drejton, këtë të mërkure, do të prezantoi para KPF-së, raportin e punës për gjashtë mujorin e parët të këtij viti, ndërsa po në të njëjtën ditë, në ora 11:00, do të zhvilloj dhe një debat publik lidhur me projekt buxhetin e vitit 2016. Sipas drejtorit Krasniqi, duke u bazuar në qarkoren e dytë buxhetore, buxheti i vitit të ardhshëm, pritet të jetë 12.3 milion euro, ndërsa ka paralajmëruar, se ministria përkatëse, pa pëlqimin e komunave, ka bërë disa shkurtime, të cilat do të sjellin probleme serioze në aktivitetet komunale.

Drejtori Krasniqi, po ashtu ka bërë të ditur, se për planifikimin në investimet kapitale, përveç debateve të këtu, do të ketë edhe takime tjera të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e vendbanimeve të Komunës së Malishevës dhe faktorët tjerë me interes, në mënyrë që planifikimi për investimet kapitale, brenda buxhetit të komunës, të jetë në harmoni me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

Një problematikë tjerë, e paraqitur në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, ishte edhe problemi i furnizimit me inventar për shkollat e reja, ndërsa drejtoritë tjera, raportuan për aktivitetet e tyre, ku u bë e ditur se janë duke vazhduar me implementim e projekteve të ndryshme. Sa i përket emergjencave, rastet e zjarreve, edhe pse me intensitet më të vogël gjatë javës, kanë vazhduar, sikurse për shkak të temperaturave, edhe në shërbimet shëndetësore, është rritur fluksi i qytetarëve që kërkojnë ndihmë mjekësore.

U mbajt dëgjimi i parë publik për projekt buxhetin 2016-2018

Malishevë, 19 gusht



Duke u bazuar në ligjin për financa, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, sot në Malishevë, ka organizuar dëgjimin e parë publik për projekt buxhetin 2016-2018, me theks të veçantë buxhetin e vitit 2016, duke u bazuar në qarkoren e dytë buxhetore. Sipas drejtorit për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, buxheti për vitin 2016 për Komunën e Malishevës, bazuar në qarkoren e dërguar nga Ministria e Financave, do të jetë 12 337

508 euro.

Drejtori Krasniqi, e ka prezantuar buxhetin para të pranishmëve në këtë dëgjim publik, ku i ka sqaruar të gjitha kategoritë buxhetore, në vija të trasha, ndërsa sipas tij, buxheti më i detajuar do të prezantohet në dëgjimin e dytë publik, ku edhe do të futen edhe projektet konkrete, të cilat do të merren, nga takimet në vazhdim, që pritet të mbahen me përfaqësuesit e fshatrave, pastaj OJQ-ve, subjekteve politike dhe grupeve tjera të interesit.

Duke u bazuar në këtë qarkore buxhetore, sipas drejtorit Krasniqi, për vitin 2016, janë paraparë 3 853 849 euro, për investime kapitale.

Në këtë dëgjim të parë, drejtori Krasniqi, ka paraqitur disa shqetësime lidhur me buxhetin, ku sipas tij do të ketë disa shkurtime buxhetore dhe më e dhimbshme, pritet të jetë tek të punësuarit, pasi sipas kufijve buxhetor, krahasuar me gjendjen aktuale, tek kategoria e pagave dhe mëditjeve, do të jenë rreth 100 mijë euro më pak dhe rrjedhimisht, si pasojë e kësaj mund të ketë edhe shuarje të vendeve të punës.

Kurse shqetësim tjetër, po ashtu i paraqitur nga drejtori, është caktimi i planifikimit për të hyrat vetanake, ku sipas tij, ministria i ka caktuar Komunës së Malishevës, rreth 300 mijë euro më shumë, se mundësitë që ka Komuna e Malishevës, për të realizuar të hyra vetanake.

Pas prezantimit të projekt buxhetit për vitet 2016-2018, drejtori Krasniqi, është përgjegjbur në pyetjet e të pranishmëve, lidhur me çështjet e ngritura.

Hyseni: Radikalizmi fetar, në kundërshtim me ajetet kuranore

Malishevë, 19 gusht

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, z.Skënder Hyseni, në kuadër të turneut të tij nëpër komunat e Republikës së Kosovës, sot ka vizituar Malishevën, ku është takuar me Kryetarin e Komunës, z.Ragip Begaj dhe me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ku është biseduar për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm.



Fillimisht, Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, duke folur për sigurinë në territorin e Komunës së Malishevës, tha se “Malisheva, vazhdon të mbaj primatin e komunës më të sigurt në vend dhe ne synojmë që ta ruajmë këtë. Kjo është rezultat i vetëdijes së lartë tek qytetarët e Komunës së Malishevës dhe bashkëpunimit të mirë me organet e rendit”.

Më pas, ministri Hyseni, tha se “qëllimi i kësaj vizite është trajtimi i temës së ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, sidomos atij fetar, ku ne si shtet i ri që jemi, duhet ta luftojmë këtë dukuri, por pa u shndërruar në dukuri, ne duhet ta parandalojmë dhe këtë më së miri e bëni ju anëtarët e KKSB-ve, përmes takimeve dhe ligjëratave që keni mundësi të bëni me qytetarët”.

“Dukuria e shkuarjes në luftime të huaja, në emër të islamit, është gabimi më i madh që bëhet, pasi dhuna, vrasjet dhe ajo luftë që bëhet, është në kundërshtim me ajetet e Kuranit dhe është keqpërdorim i fesë islame, pasi të qenit islam, nënkupton të jesh në paqe, ndërsa luftërat si në Siri dhe vende tjera, janë të pakuptimta”, tha ministri Hyseni.

Ai më pas foli edhe për angazhimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme në luftimin dhe parandalimin e kësaj dukuri, ku sipas ministrit Hyseni, “Policia e Kosovës, është duke e kryer punën e saj në mënyrën më të mirë të mundshme, ndërsa do të jetë e pa kompromis në luftimin e dhunës, ekstremizmit dhe radikalizmit, të të gjitha formave”.

Edhe anëtarët e KKSB-së në Malishevë, shprehën qëndrimin e tyre rreth kësaj teme, e në veçanti krerët e Bashkësisë Islame në Malishevë, ku sipas tyre “imamët dhe predikuesit fetar në Malishevë, çdo ditë dhe në çdo rast, mbajnë ligjëratat dhe shpjegojnë për islamit dhe kundër dukurive të këtilla”, përderisa e vlerësuan të mirë gjendjen në Malishevë, pasi kjo dukuri nuk është shumë e shprehur.

Pas kësaj teme, duke trajtuar çështje të ndryshme të sigurisë së përgjithshme në Malishevë, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, shprehi shqetësimin e tij, për trajtim jo të duhur nga ana e departamentit të emergjencave, në raport me Komunën e Malishevës, ku sipas drejtorit Morina, “nga ky departament, Malisheva është e lënë anash”.

Përndryshe, ministri Hyseni, në këtë takim, duke ju drejtuar kryetarit Begaj dhe anëtarëve të KKSB-së, tha se “ministra që ai drejton, me seriozitetin do ti marr të gjitha kërkesat e Komunës së Malishevës”.

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) mbajti mbledhjen e tetë të rregullt

Malishevë, 19 gusht

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, sot ka mbajtur mbledhjen e saj të tetë të rregullt, ku edhe i kanë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, në mesin e tyre janë shqyrtuar edhe disa kërkesa, ku dy nga to edhe janë rekomanduar për kuvend.

Anëtarët e KPF-së gjatë kësaj mbledhje kanë shqyrtuar dhe rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të kuvendit këto pika Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2015, pastaj kanë shqyrtuar i raportit të punës së DKAE-së, Janar-Qershor 2015 dhe shqyrtimi dhe miratimi i projekt -Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve.

Në mes tjerash KPF, ka shqyrtuar edhe disa kërkesa, ndërsa për kuvend janë rekomanduar dy: e para, kërkesa për mundësi lirimi nga taksa për leje urbanistike, për të gjithë fermerët të cilët kanë përfituar grante stimuluese nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe kërkesa e dytë, për caktim të lokacionit me hapësirë prej dy hektarësh në territor të komunës për të realizuar projektin “Riciklim, ambalazhim dhe asgjësim të mbeturinave”.

Nga 1 shtatori ndalohet ekspozimi i mallit para lokaleve dhe sipërfaqeve tjera publike

Drejtoria për Inspektoriatë lëshon urdhëresë për të gjithë personat përgjegjës të subjekteve afariste, personat fizik , që të mos bëjnë ekspozimin dhe shitjen e produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, para lokaleve dhe sipërfaqeve tjera publike në Malishevë.Në rast të mos zbatimit të Rregullores dhe kësaj urdhërese nga ana e juaj dhe do të veproni në kundërshtim me nenet 12, 13 të Rregullores Komunale nr .01/489 datë 20/04/2010 jemi të obliguar të marrim masa për zbatimin e plot të kësaj urdhërese dhe njëherësh të shqiptojmë këto masa ndëshkuese sipas nenit 26 të kësaj rregullore.

U mbajt dëgjimi i dytë për projekt buxhetin 2016-2018 për Komunën e Malishevës

Krasniqi: 3.8 milion euro për investime në vitin 2016

Malishevë, 24 gusht

Organizuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Malishevës, sot është mbajtur dëgjimi i dytë publik, për qarkoren e dytë buxhetore, për projekt buxhetin e viteve 2016-2018, me theks të veçantë për buxhetin e vitit 2016, ku pas prezantimit të buxhetit, të pranishmit, kanë dhënë edhe propozimet e tyre lidhur me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, në raport me investimet kapitale.



Prezantimin e projekt buxhetit e ka bërë drejtori i drejtorisë , z.Vesel Krasniqi, sipas të cilit, buxheti i përgjithshëm i paraparë për Komunën e Malishevës, është 12 milion e 337 mijë e 508 euro, ndërsa për investime kapitale, janë të parapara 3 milion e 853 mijë euro.

“Ka disa shkurtime buxhetore dhe thënë në gjuhën popullore, Ministria e Financave, na ka prerë këmishën, pa na pyetur, pasi vet i ka caktuar kufijtë buxhetor, pa i marrë parasysh propozimet tona dhe më e keqja është se FMN-ja, e ka kufizuar buxhetin për paga dhe medijtje, kurse Ministria e Financave, këtë shkurtim buxhetor e ka bërë në komuna dhe jo nëpër ministri dhe si rezultat, nëse kjo nuk rregullohet në qarkoren e tretë buxhetor, rrezikohen të humben 15 vende pune në Malishevë, sikur edhe nëpër komunat tjera të vendit”, tha drejtori Krasniqi.

Përndryshe, projekt buxheti është prezantuar para të pranishmëve, ku drejtori Krasniqi, përveç shpjegimit të vijave buxhetore, buxhetin e ka paraqitur edhe në mënyrë të detajizuar, kurse ka kërkuar përfaqësuesit e fshatrave, që kërkesat e tyre, në raport me investimet, ti bëjnë me kohë, në mënyrë që projektet të planifikohen, duke u bazuar në kërkesat e fshatrave dhe të OJQ-ve.

“Logjika e qeverisjes sonë është kjo, që investimet të orientohen duke u bazuar në kërkesat e komunitetit, prandaj edhe realizimi i buxhetit, edhe realizimi i investimeve, sikur edhe miratimi i buxhetit, është më i lehtë dhe më i sigurt, pasi kjo bëhet në bashkëpunim me qytetarin”, tha drejtori Krasniqi.

Të pranishmit, i kanë dhënë disa mendime të tyre dhe propozime, lidhur me orientimin e buxhetit, në veçanti, të investimeve, ku kërkesë kryesore edhe këtë vit, është vazhdimi i investimeve në infrastrukturën në përgjithësi.

Në ditën e Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”, nderohen dëshmorët e kombit

Kleçkë, 25 gusht



Sot në varrezat e dëshmorëve të Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”, në Kleçkë, me rastin e shënimit të Ditës së Brigadës dhe rënies së dëshmorit të kombit Ismet Jashari, janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë, ku prehen dëshmorët e kësaj brigade.

Përveç familjarëve, pjesëtarëve të ish UÇK-së nga kjo brigadë, homazhe dhe nderime, kanë bërë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Enver Hoti, anëtar të qeverisë komunale, dhe qytetar të tjerë.

Pastrohet shtrati i lumit Mirusha, pjesa që kalon nëpër qytet

Malishevë, 25 gusht



Gjatë ditëve të fundjavës, kompania për menaxhimin e mbeturinave “Eko regjioni”, njësia në Malishevë, ka pastruar shtratin e lumit “Mirusha”, pjesa që kalon përgjatë qytetit të Malishevës. Përgjatë shtratit të lumit ka pasur mbeturina, kryesisht shishe të plastikës dhe shishe xhami, të hedhura nga persona të pandërgjegjshëm.

Po ashtu qëllim tjetër i pastrimit të lumit, ishte edhe mbrojtja e gjallesave që rriten ujërat e lumit, gjegjësisht peshkut, si dhe krijimi i një pamje më të mirë.

Me këtë rast, lutem qytetarët, që të mos derdhin mbeturinat në lum dhe ta ruajnë këtë pasuri të paçmuar.

Komiteti për Komunitete, mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 28 gusht

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, sot ka mbajtur mbledhjen e rregullt të tij, ndërsa kjo mbledhje është drejtuar nga zëvendëskryesuesi i këtij komiteti, z.Naser Malisheva. Në këtë mbledhje, anëtarët e komitetit morën vendim për shtyrjen e vizitës së planifikuar.

Anëtarët e komitetit, që ishin të pranishëm, unanimisht shtynë vizitën e planifikuar, për në pishinat e Banjës, me arsyetim se mungonte në këtë takim, kryesuesi i komitetit, z.Labinot Gashi, ndërsa sipas tyre, në atë vizitë është mirë që të jenë sa më shumë anëtar të komitetit, së bashku me kryesuesin e komitetit.